

RAPORTI I FESTIVALIT

EDICIONI XXI - 5-13 GUSHT 2022 - PRIZREN, KOSOVË

HOW TO



SURVIVE...?

DOKU FEST

**DOKU
FEST**

International Documentary
and Short Film Festival

263 FILMA

52 SHTETE

8 DISKUTIME

3 MASTERKLASA

4 PUNËTORI

2 EKSPozITA

14 k. PJESEMARRËS


130 VULLNETARË

110 TË PUNËSUAR





FESTIVALI NË NUMRA



PËRMBLEDHJE

Edicioni i 21-të i DokuFest-it – Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër, u mbajt në qytetin e Prizrenit nga data 5 deri më 13 gusht 2022. Pas dy vitesh të vështira, festivali u rikthye në formatin e tij të plotë me pjesëmarrje fizike, duke sjellë një program të pasur me shfaqje filmash, debate e diskutime, masterklasa dhe ngjarje muzikore.

Publiku, qofshin ata profesionistët, talentët e rinj apo dhe fëmijët pa përjashtim, patën mundësi të ndjeknin aktivitete që organizoheshin në pjesë të ndryshme të qytetit, duke sjellë kështu shijen e festivalit edhe në ato lagje që zakonisht u mungon jeta kulturore.

Në dhjetor të vitit 2021, ekipi menaxhues i festivalit u mbledh për të analizuar edicionin paraprak, për të nxjerrë disa nga anët pozitive të versionit kryesisht dixhital apo edicionit hibrid dhe për të diskutuar lidhur me mësimet e nxjerrura prej tij dhe cilat aspekte do të mund të aplikoheshin edhe në edicionin e sivjetshëm. Natyrisht, plani ishte që të ktheheshim në një edicion të plotë me pjesëmarrje fizike, me shtrirje të plotë të programeve, për të cilat jemi të lumtur të raportojmë se i kemi arritur pothuajse plotësisht. Ekipi diskutoi gjithashtu temat e mundshme të festivalit, duke u pajtuar se nevojiten diskutime shtesë në ditët më afër datave të planifikuara për mbajtjen e festivalit.

Ngjarjet botërore në shkallë të gjerë, si fillimi i luftës në Ukrainë dhe fatkeqësitë e shpeshta shkatërruese natyrore në të gjithë botën, ishin arsyeja kryesore që na shtyu ta përzgjedhnim temën e mbijetesës si pikën qendrore të festivalit. Përmes temës së parashtruar për herë të parë në historinë e festivalit në formën e një pyetjeje, **SI TË MBIJETOSH...?** jemi përpjekur të trajtojmë të gjitha shqetësimet e lartpërmendura. Rrjedhimisht, disa nga pyetjet e parashtruara ishin: Si t'i mbijetojmë vapës, përmytjeve, dhunës, pandemisë, inflacionit, luftërave, fashizmit dhe përfundimisht zhdukjes.

Formulimi i temës në formë të një pyetje ofroi një hapësirë shumë të nevojshme për njerëzit që të angazhoheshin dhe të ndanin përvojat e tyre, duke marrë parasysh përvojën kolektive të përballjes me çështjet e lartëcekura me një ritëm alarmues të zhvillimit gjatë dy viteve të fundit. Nëpërmjet bisedave dhe debateve të shumta me të ftuar, mendimtarë dhe ekspertë, festivali u përpoq t'i jepte përgjigje këtyre pyetjeve ekzistenciale, në një kohë kur mbijetesë në një botë të trazuar dhe një planet të lënduar është bërë një domosdoshmëri për të gjithë ne. Pra, po flasim për një planet që tani po ndryshon në një mënyrë thelbësore, të tmerrshme e të dukshme dhe i cili së shpejti mund të jetë një planet në vdekje nëse nuk ndërmerret asnjë veprim.

Një numër i konsiderueshëm i filmave të përzgjedhur për festivalin prekën çështjen e mbijetesës në forma të shumta. Krijuesit e filmave dokumentarë janë ndër të parët që reagojnë ndaj ngjarjeve rreth nesh, duke bërë vepra arti të lavdishme dhe prekëse, ndonjëherë duke paguar çmimin më të lartë në përpjekjet e tyre për t'i

rishfaqur këto histori para publikut. Një ngjarje e tillë ishte një histori e banorëve të bllokuar të qytetit të Mariupolit në filmin e llahtarshëm *Mariupolis 2* të regjisorit të ndjerë lituanez Mantas Kvedaracivius. Ose filmi *Navalny* i Daniel Roher, që tregon historinë e pabesueshme të mbijetesës së Alexei Navalny-it pasi u helmua, liderit kryesor të opozitës ruse dhe një kritik i ashpër i Putinit.

Kishte filma për ata që nuk mundën ose nuk mbijetuan, si historia e Kimi-it të gjorë në filmin *How to Save a Dead Friend* (Si të shpëtosh një mik të vdekur) të Marusya Syroechkovskayas; ose portreti rrëqethës i qindra zogjve që bien nga qielli në Nju Delhi në filmin mahnitës *All That Breathes* (Gjithçka që merr frymë) nga Shaunak Sen, si dhe historia e bukur e dashurisë dhe e mbijetesës së dy vullkanologëve, Katia dhe Maurice Krafft, e paraqitur në filmin e regjisores amerikane Sara Dosa, *Fire of Love* (Zjarri i dashurisë). Nëpërmjet punës së përkushtuar të Krafft, u shpëtuan jetë të panumërta për shkak të kërkimit dhe rreziqeve të mëdha të punës të cilën ata e deshën mbi gjitha çka tjetër.

Si gjithmonë, garat ishin në qendër të përzgjedhjes sonë e cila këtë vit ishte mbresëlënëse si kurrë më parë. Filmat e paraqitur në **Balkan Dox Competition** ofruan një vështrim të gjerë të prodhimit dokumentar në rajon, duke përfshirë një depërtim në ujëra të ndryshme stilistike me shumë zgjedhje të guximshme artistike. Vazhduam me vënien e theksit në çështjet e të drejtave të njeriut dhe atyre mjedisore në seksionet **Human Rights** dhe **Green Dox Competition**, duke shfaqur filma rreth disa prej temave më urgjente dhe në nevojë të trajtimit të ditëve tona.

Gara e Short Films solli disa nga më të mirët e ekranit të argjendit të filmave të shkurtër, duke përfshirë filmat fitues të çmimeve të Cannes dhe Sundance. Seksioni ynë i **International Dox Competition** vazhdoi të ishte një vend zbulimi, si për ne ashtu edhe për audiencën tonë. Një numër filmash nga kjo rrymë luanin lirisht me kodet, duke përzier zhanret dhe mënyrat e rrëfimit, duke sinjalizuar kështu një zhvendosje në një praktikë më eksperimentale të tregimit, jolineare në realizimin e filmave dokumentarë.

Shfaqëm gjithashtu një listë po aq mbresëlënëse të filmave në **National Competition**, të përgatitur si nga kineastët e ardhshëm ashtu edhe nga ata më me përvojë. Një pjesë e ekspozitës paraqiti 25 filma të shkurtër të posabërë nga Future is Here, Youth Film Camp, MakeDox dhe programet rajonale të trajnimit Free Zone, të cilët tërhoqën një numër rekord të audiencës sonë. Edhe një herë duke na bërë shumë entuziastë për të ardhmen e kineastëve në Kosovë dhe duke pasur si synim



nxitjen e kineastëve të rinj, me krenari i dhuroam një çmim projektit të Flutura Balaj 'Transmission' përmes skemës **New Wave Grant**. Granti në shumën prej 10.000 eurove që shkon për prodhimin e një filmi të shkurtër është përkrahur me zemërgjerësi nga SIDA dhe Ambasada Suedeze në Kosovë.

Për edicionin e 21-të të festivalit u prezantuan 13 programe të përzgjedhura në mënyrë të veçantë. Programe të tilla si **View from the World**, **Sonic Transmissions: Music on Film** dhe **Future is Here** sollën sërish filma emocionues. Kishim kënaqësi të paraqisnim gjithashtu një mori programesh të përzgjedhura, si **Football Shorts**, programin fantastik **Double Burdens: Exposures & Expressions**, programi me përzgjedhje nga organiztorja e ftuar e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Toronto, Dorota Lech, **Surviving You, Always: The Works of Maryam Tafakory dhe Morgan Quaintance**, përzgjedhur nga bashkëpunëtorja jonë e kahmotshme Pamela Cohn, **Landscapes of Repair and Resistance** në bashkëpunim me Manifesta 14 Nomadic Biennale, **Artistic Differences: Under a Roof** në bashkëpunim me UnionDocs me qendër në Nju Jork, **Lumbardhi LXX** në bashkëpunim me Fondacionin Lumbardhi, **European Short Film Tour** në bashkëpunim me Akademinë Evropiane të Filmit, që përkon me njohjen e DokuFest-it si një festival nominues për filmin më të mirë evropian të shkurtër, si dhe për filmin më të mirë dokumentar artistik evropian në European Film Awards (Çmimi Evropian i Filmit), si dhe disa programe të tjera.

Siç është zakon për DokuFest-in, tema u theksua edhe përmes fushatës së festivalit dhe gjatë

programeve të tij, masterklasave, punëtorive bashkëpunuese dhe performancave të larmishme muzikore.

DokuFest-i filloi të pranoj aplikime për filma për edicionin e tij të 21-të nga data 1 nëntor 2021 deri më 28 shkurt 2022. Në fillim të korrikut u shpall formati i plotë i festivalit. I përmbledhur nga një numër rekord aplikimesh, ekipi i programeve të drejtuar nga drejtori ynë artistik, përzgjedhi për të shfaqur **263 filma** nga mbi **52 shtete** të ndryshme në **8 seksione garuese** dhe **13 programe** të përzgjedhura në mënyrë të veçantë.

Kthimi në formatin e plotë të programeve tona për një edicion me pjesëmarrje fizike solli në festival rreth 100 kineast dhe profesionistë të filmit, një numër artistësh dhe profesionistësh të njohur ndërkombëtarë, një mori muzikantësh, ekspert të kulturës dhe mendimtarë, duke tërhequr kështu në mënyrë të konsiderueshme vëmendjen dhe mbulimin mediatik. Për të mbuluar edicionin e 21-të të festivalit, u akredituan mbi **100 përfaqësues të medias** dhe gjatë rrugës zgjeruam partneritetin tonë mediatik me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Pak më shumë se një javë përpara nisjes zyrtare të festivalit më 5 gusht, DokuFest zbuloi disa nga filmat e edicionit të këtij viti me shfaqjen e pesë prej tyre në Tirana Open Air, në bashkëpunim me **Harabel Contemporary Art Platform**. Paralelisht me periudhën kohore të shfaqjeve të filmave në Tiranë, aktiviteti fillestar për programin **DokuKids** nisi me Shkollën Verore KIST në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP) në Prizren. Shkolla Verore u organizua në kuadër të projektit KIST të DokuLab, një departament i

DokuFest-it që organizon aktivitete gjatë tërë vitit. Përgjatë periudhës 5-ditore të shkollës verore, fëmijë të shkollave fillore patën mundësi të merrnin njohuri lidhur me tregimin e historive dhe krijimin e animacioneve të llojit stop-motion.

ITP në Prizren vazhdoi të jetë vendi qendror për të gjitha programet e DokuKids gjatë gjithë festivalit, me 47 shfaqje filmash dhe 4 punëtori, me tema unike dhe edukative për fëmijë.

Duke marrë parasysh zgjerimin e vazhdueshëm të DokuFest-it në ambiente të ndryshme rreth e qark Prizrenit – këtë vit duke arritur në **12 kinema** ku u shfaqën filmat –siguroam transport falas me autobus nga qendra e qytetit për në kinema dhe ambiente të ndryshme ku zhvilloheshin shfaqjet dhe aktivitetet e filmit, kështu që ky edicion pati audiencën tonë DokuBus në të gjithë qytetin.

Në edicionin e 21-të u rikthye një nga elementët kryesorë të tij, programi muzikor **DokuNights** i kuruar nga Leart Rama ishte i përbërë kryesisht nga muzika e zhanrit tekno dhe elektronike. DokuNights trajtoi temën e festivalit përmes një lente më optimiste me titullin e përzgjedhur **MUSIC OF THE FUTURE**, për shkak të tingujve karakterizues futuristik të disa prej interpretuesëve kryesor si *Hercules and Love Affair*, *Zebra Katz*, *Sega Bodega*, *DMX Krew*, *Detroit in Effect* dhe *Roza Terenzi*.

Një tjetër program i rikthyer me pjesëmarrje fizike për edicionin e 21-të të festivalit ishte edicioni i 9-të i **DOKU.TECH**, një projekt bashkëpunimi ndërmjet IPKO Foundation, DokuFest dhe SHARE Foundation. Ky program solli një numër autorësh të famshëm, si Dan McQuillan, themelues dhe kryeshef ekzekutiv i Omdena Inc, Rudradeb Mitra,

bashkëpunëtor postdoktorant në Data & Society në Nju Jork e Tiara Roxanne, për një konferencë teknologjike njëditore me temën **‘My face is not a Barcode’** për të eksploruar mundësitë dhe kërcënimet e Inteligjencës Artificiale dhe të të Dhënave.

Programi në rritje i bisedave dhe diskutimeve nën flamurin DokuTalks u përbë nga **8 panele diskutimesh**, **3 masterklase** dhe **4 punëtori** të DokuKids. Për herë të parë, DokuFest ishte pjesë e një bashkëpunimi në mes të Shkollës Verore Ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe ITP. Diskutimet në panel, të bashkë-drejtuar nga Eroll Bilibani dhe Dea Gjinovci dhe moderuar nga Gjinovci, shpalosën një gamë të gjerë temash, nga ajo e mbijetesës dhe përballjes me krizën klimatike, te fuqia e filmave jo-trillues dhe çfarë ndodh me personazhet në to dhe deri në ekonominë e industrive të bazuara në të drejtat e autorit.

Sistemi i numërimit të biletave na ka mundësuar të arrijmë në përfundim se numri i pjesëmarrësve në të gjitha aktivitetet tona ka arritur në rreth **14,000 persona**.

Mbledhja e fondeve të festivalit është arritur përmes një kombinimi të mbështetjes financiare nga institucionet shtetërore qendrore dhe lokale, fondacionet ndërkombëtare, sponzorët komercialë dhe ambasadave të huaja në Kosovë.

Festivali u organizua përmes një pune të palodhshme të një force ekipore prej 110 personash të përkushtuar të angazhuar me orar të plotë e të pjesshëm dhe prej 130 vullnetarësh po aq të përkushtuar.

Shfaqjet e DokuNight që u zhvilluan në 8 nga 9 ditët e festivalit, zunë vend në 2 skena. Në **Lumbardhi Kino Bahçe** përjetuam artin kosovar në maksimum, me performancën eterike të artistes vendase të zhanrit indie, *Edona Vatoci*, dhe yjeve në ngritje të elektroskenës alternative në Kosovë, *‘This is Not’*, si dhe performancën e interpretuesëve kryesorë të DokuNights, grupit legjendar, *Hercules & Love Affair*, i cili u organizua së bashku me Fondacionin Lumbardhi. Pjesa tjetër e shfaqjeve u zhvilluan në **Andrra Stage**.





PROGRAMET E VEÇANTA

VIEW FROM THE WORLD

DokuFest ka vazhduar të paraqes vepra të jashtëzakonshme kinematografike përmes programeve të tij të përzgjedhura me kujdes të posaçëm. Për kënaqësinë e audiences, si në rastin e përzgjedhjes së bërë nga brenda, ashtu edhe me përzgjedhjen e bërë nga disa prej programuesve kryesorë botërorë të ftuar, ishim të lumtur të shfaqim filma të rinj dhe të shfaqur rrallë herë.

Programi i shumë admiruar **View From the World** i festivalit solli 15 filma të përzgjedhur me kujdes, mes tyre disa nga veprat jo-trilluese (non-fiction) më të bukura dhe më të guximshme të vitit, duke përfshirë debutimin e jashtëzakonshëm të *Fire of Love* të Sara Dosa-s, duke vendosur kështu standardin për atë që do të vinte gjatë gjithë festivalit.

Të freskët nga festivali i Kanës erdhën dy filma të jashtëzakonshëm për mbijetesën, *How to Save a Dead Friend* dhe *Mariupolis 2*. I filmuar gjatë 12 viteve, *How to Save a Dead Friend* është një thirrje personale nga zemra dhe një mesazh nga një brez i heshtur i të rinjve në Rusi, ndërsa në *Mariupolis 2* shohim një kronikë të të mbijetuarve të Mariupolit që kërkojnë strehim nga tmerret e luftës.

Një tjetër film i jashtëzakonshëm i titulluar *Navalny* kishte të bënte me mbijetesën e politikanit të famshëm opozitar rus, Alexei Navalny, pas helmimit të tij dhe kthimit në Rusi.

Një numër i kineastëve të rikthyer në festival, si: Yuri Ancarani me *Atlantide*, Travis dhe Eris Vilkersson me *Nuclear Family*, Michelangelo Frammartino me *Il Buco*, Tin Dirdamal me *Dark Light Voyage*, Aliona van der Horst me *Turn Your Body to the Sun* dhe Ruth Beckermann me *Mutzenbacher*, panë filmat e tyre të shfaqeshin në këtë program.

Përzgjedhjen e këtij programi e përmbyllën tre filma të jashtëzakonshëm, *Kash Kash - Without Feathers We Can't Live* nga Lea Najjar, *Republic of Silence* nga Diana el Jeiroudi dhe *The Plains* nga David Eastal.

DOUBLE BURDENS: EXPOSURES & EXPRESSIONS

Dy programe të drejtuara nga të ftuarit ishin ndër pikat kryesore të festivalit. Njëri nga ta ishte *Double Burdens: Exposures & Expressions*, drejtuar nga e ftuara ekskluzivisht për këtë edicion të festivalit programuesja e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Toronto, Dorota Lech. Filma si *Daisies* nga regjisorja legjendare çeke Vera Chytilova, *The Tied-Up Balloon* nga regjisorja e njohur bullgare Binka Zhelyaskova, *Brief Encounters* nga regjisorja ukrainase Kira Muratova, *The Mona Lisa Without a Smile* nga rumunja Malvina Urshianu dhe *My 20th Century* nga hungarezi Ildiko Enyedi ofruan një vështrim astronomik mbi kinemanë feministe nga ana tjetër e Perdes së Hekurt.

SURVIVING YOU, ALWAYS: THE WORKS OF MARYAM TAFKORY & MORGAN QUAINTANCE

Në përputhje me përzgjedhjen tematike të DokuFest-it për edicionin e tij të 21-të, "Si të mbijetosh...?", bashkëpunëtorja jonë e kahmotshme, Pamela Cohn, udhëhoqi një ekspozitë të dy artistëve/regjisorëve, Maryam Tafakory dhe Morgan Quaintance. *The Surviving You, Always* solli veprën me imazhe lëvizëse të artistëve, Maryam dhe Morgan, të cilët kanë prodhuar një trup emocionues të veprës në zhvillim në disa vitet e fundit.

Puna e të dy artistëve me bazë në Londër u shfaq në dy paraqitje të veçanta, duke përfshirë lexime të drejtpërdrejta, performancë, vështrime në veprat në zhvillim dhe praninë e të dy krijuesve në festival, si dhe në një seancë të zgjeruar takimi me të dy artistët, në bisedë me Pamela Cohn.



FOOTBALL SHORTS

E dyta me radhë pas dashurisë sonë për filmin, ne festuam pasionin tonë për futbollin duke shfaqur një përzgjedhje prej 24 filmash për lojën më të mirë të zbuluar ndonjëherë! Duke pritur me ankth Kupën e Botës së FIFA-s në Katar këtë nëntor, patëm mundësinë të shijonim lavditë e shumta të lojës në DokuFest.

Nëpërmjet këtij programi patëm mundësinë të dëshmojmë gjithçka që ndodh në lojën e futbollit, si për shembull disa prapaskena magjepsëse që krijuan histori unike, duke përfshirë filma për një gjyqtar, Zlatanin e Madh, futbollin si mjet për migrim dhe shumë të tjera. Prandaj, në programin *Football Shorts* brohoritnim rroft futbollit.




SONIC TRANSMISSIONS

Besnik ndaj frymës së tij për të eksploruar gjithçka dhe çdo gjë që lidhet me muzikën dhe filmin, DokuFest shfaqti 8 dokumentarë të jashtëzakonshëm muzikorë brenda seksionit të tij *Sonic Transmissions: Music on Film*.

Duke përfshirë një numër të larmishëm zhanresh - nga ato elektronike dhe grunge, tek klasikët dhe madje edhe ato folklorike -, filmat çuan audiencën tonë në një univers magjepsës të diversitetit muzikor, nga muzika e pavarur e komunitetit turk në Gjermani dhe shtyllën e tyre të shprehjes kulturore në *Love, Deutschmarks and Death*, e deri te integrimi i muzikës në tregimin e historisë së Jean, e cila është duke u rritur në një komunitet në ndikimin e një udhërrëfyesi shpirtëror, në filmin *Spectre: Sanity, Madness & the Family* duke përfshirë edhe shumë tema tjera.

Portrete të muzikantëve emblematicë, si ai i kompozitorit më të madh të filmit në botë, Ennio Morricone, me përshkrim për *Ennio-n*, ose ato për emrat e njohur dhe më pak të njohur nga skena punk, në filmat për Patti Smith, Dinosaur Jr. dhe grupin e Afrikës së Jugut The National Wake, në *Pati Smith: Electric Poet*, *Freakscene: The Story of Dinosaur Jr.* dhe *This is National Wake* që të gjitha mund të gjindeshin këtu.

Në përmbyllje të programit u shfaqën dy filma për dy muzikantë unikë, njëri për një pianist dhe kompozitor legjendar i xhazit Thelonius Monk në *Rewind & Play* dhe tjetri për këngëtarin-kantautorin e jashtëzakonshëm boshnjak, Bozho Vreço në *Maldita: A Love Song to Sarajevo*.



ARTISTIC DIFFERENCES: UNDER A ROOF

Jemi jashtëzakonisht të kënaqur që bashkuam forcat me UnionDocs me bazë në Nju Jork dhe nisëm aktivitetin e parë të një seri ngjarjesh, të titulluara *Under a Roof*, duke lançuar kështu Artistic Differences, pjesë e programit UnionDocs BREAK OUT. Programi krijon hapësirë për shpërndarjen dhe reagimin me guxim ndaj artit sfidues të dokumentarëve, duke ftuar një audiencë të larmishme në një seri mujore programesh të filmave dhe grupeve studimore dhe duke i sjellë ato zëra në skenën e dialogut publik. *Under the Roof* trajtoi çështjen nga këndvështrimi se çfarë do të thotë të gjesh shtëpinë në një vend, në një praktikë apo në një ritual?



Për t'u zhytur në këtë vështrim qendror, prezantuam dy filma si pjesë e programit, *117* nga regjisori i ndjerë kosovar Besim Sahatçiu dhe *O Movimento das Coisas / Lëvizja e gjërave* nga kineastja portugeze Manuela Serra. Shfaqjet e filmit në DokuFest u pasuan me një bisedë mes shkrimtarit dhe kritikut kulturor Boris Buden, sociologut dhe shkrimtarit kosovar Sezgin Boynik dhe kineastes Manuela Serra.

E bashkëprogramuar me Cintia Gil, një programuese portugeze dhe kritike e dokumentareve, kjo përvojë kolektive na dha pak njohuri se si mund të krijojmë hapësirë publike për një bashkëbisedim më të mirë rreth filmit dokumentar.

THE EUROPEAN FILM ACADEMY'S SHORT FILMS ON TOUR

Si rezultat i një bashkëpunimi të gjatë midis Akademisë Evropiane të Filmit dhe DokuFest-it, ky edicion shënoi vitin e 10-të të shfaqjes së filmave më të mirë evropianë të shkurtër dhe erdhi pas pranimit të DokuFest-it nga Akademia, si një festival nominues për filmin më të mirë evropian të shkurtër, si dhe dokumentarin më të mirë evropian.

LANDSCAPES OF REPAIR AND RESISTANCE: MANIFESTA 14 PRISHTINA SPECIAL PROGRAMME AT DOKUFEST

Bashkëpunimi me *European Nomad Biennale* (Bienalen Nomade Evropiane), me rastin e edicionit të tyre të 14-të që po mbahej në qytetin e Prishtinës, solli në festival programin *Landscapes of Repair and Resistance* që u zhvillua në formën e tri shfaqjeve filmike dhe të një diskutimi, duke trajtuar temën e peisazhit me gërshetim të rrëfimeve historike dhe bashkëkohore të rezistencës, rimëkëmbjes, shërimit dhe riparimit.

LUMBARDHI LXX

Me rastin e 70 vjetorit të kinemasë ikonike Lumbardhi, një përzgjedhje mbresëlënëse e filmave me vlerë shoqërore, kulturore dhe artistike u mbledhën për ta shënuar këtë datë.

Filmat e hershëm të luftës sovjetike, melodramat amerikane, filmat e neorealizmit italian dhe Vala e Re franceze, filma amerikanë dhe të zhanrit Spaghetti western, filmat propagandistikë, si dhe një listë mbresëlënëse e pothuajse çdo filmi jugosllav të prodhuar në atë kohë, duke përfshirë edhe të epikës së famshme të luftës, ishin të gjitha pjesë e kësaj përzgjedhjeje prej 70 filmash që në kinema Lumbardhi vazhdojnë të shfaqen që nga muaji shkurt.

Për t'iu bashkuar festës, DokuFest solli në festival një përzgjedhje të vogël prej pesë filmash, duke përfshirë *Blue Velvet* të David Lynch, *Early Works* të Zhelimir Zilnik dhe *Edipus Rex* të Pier Paolo Pasolini, *It Rains in My Village* të Aleksandar Petroviq-it dhe filmin përmbyllës të festivalit *The Last Waltz* të Martin Scorsese.

FUTURE IS HERE



Ky vit shënoi vitin e 10-të të programit tonë kryesor të trajnimeve për film Future is Here, i mbështetur me zemërgjërësi dhe në vazhdimësi nga National Endowment for Democracy. Gjatë një periudhe gjashtëmujore, 21 nxënës të shkollave të mesme prodhuan shtatë filma dokumentarë të shkurtër që trajtonin një gamë të gjërë çështjesh. U mahnitëm përsëri me potencialin artistik të të rinjve në Kosovë përmes filmave që trajtonin historitë e kaluara përmbledhëse të pionierëve të pajtimit të gjaqeve në fillim të viteve 90-ta, përmes një historie të bukur dashurie, pavarësisht situatës zemërthyesë, e deri te portretizimet e betejave shumë personale të të rinjve.

Në vitin 2021, filluam një bashkëpunim të ri me Misionin e OSBE-së në Kosovë për të ofruar mbështetje për Valën e Re të kineastëve të Kosovës duke organizuar kampe filmike për të rinjtë me qëllim të eksplorimit të të drejtave të njeriut përmes prodhimit të filmave dokumentarë kreativ. Përmes një procesi të krijimit të filmave bashkëpunues, 18 pjesëmarrës nga Kosova, Serbia dhe Mali i Zi, prodhuan pesë dokumentarë të shkurtër që shpalosin sfidat e pjesëtarëve më pak të përfaqësuar të shoqërisë.

Nga një vëzhgim eksperimental i një mbledhësi të kanaqeve që jeton në varfëri ekstreme e deri te një histori e një gruaje drejt rrugëtimit të saj për të gjetur veten, secili film solli një këndvështrim të

fortë të autorëve që ndërlidheshin ngushtë me temën e filmave të tyre.

Që të dy kampet u udhëhoqën nga regjisorja fituese e çmimeve Blerta Zeqiri, ish-studenti i Future is Here, Leart Rama dhe drejtuesi i departamentit tonë për çështje arsimore DokuLab, Eroll Bilibani.

Partneriteti ynë i kahmotshëm me festivalet e filmit Free Zone nga Beogradi dhe MakeDox nga Shkupi solli histori të ngjashme të prodhuara përmes iniciativave të tyre të trajnimeve për film. 14 filma u shfaqën në një përzgjedhje speciale nga partnerët tanë, dhe DokuFest priti kineastët e rinj vizitorë në festival.



Për kënaqësinë e fëmijëve, pas dy vitesh mungese të audiencës sonë të preferuar, DokuKids u rikthye me programin e tij të plotë. Gjatë 6 ditëve të festivalit, ambientet e ITP-së u mbushën me më shumë se 300 fëmijë të grupmoshave të ndryshme që morën pjesë në punëtori apo që erdhën për të parë kryesisht filma të animuar. Gjithsej 47 filma të animuar u shfaqën gjatë këtyre 6 ditëve nga ora 10:00 – 12:00 pa pagesë për audiencën tonë më të re.

STOP MOTION ANIMATION WORKSHOP

Trajnimi i udhëhequr nga dy profesioniste çeke për animacione, Viktorie Stepanova dhe Luna Mascha Vielandova përfshiu trajnime në fushën e animacionit stop-motion duke u dhënë fëmijëve dhe të rinjëve aftësi digjitale me qëllim që të ndihmohen të zhvillojnë kapacitete për të ardhmen e industrive kreative në Kosovë. Filmat e animuar të realizuar nga studentët me vetëm 3 ditë punë, u shfaqën në ceremoninë përmbyllëse të DokuFest-it. Gjithsej 28 pjesëmarrës të moshës 10-14 vjeç u angazhuan në krijimin e filmave të animuar me temën e festivalit Si të mbijetosh.

POP-HOP STUDIOS WORKSHOP

Pop-Hop Studios solli një grup filmash pop-up që u mundësuan pjesëmarrësve të DokuKids të mësonin shpejt dhe në mënyrë bashkëpunuese rreth fjalorit kinematografik dhe teknikave të filmave të animuar. Të udhëhequr nga Jeremy Laurichesse, prezantuam një punëtori për prodhimin e filmit të animuar që shpesh përfshin trajtimin e të njëjtit paraprodhim për periudha të shkurtra kohore (2-3 orë), të cilave u shtohet një fillim i shkurtër i xhirimit, montazhit dhe dizajnit të zërit.

Secila punëtori 3 ditore prej 3 orësh ofroi mësimin e fjalorit kinematografik dhe teknikave të filmit të animuar për 36 fëmijë të moshës 8-10 vjeç, të cilët si rezultat prodhuan animacione të shkurtra që u shfaqën në ceremoninë përmbyllëse të festivalit.

PAINTING WORKSHOP

“Gishtat”, një kompani me seli në Prishtinë, ishte nikoqire e një punëtorie tjetër e organizuar nga DokuKids që mësonte fëmijët se si të pikturonin. Bazuar në temën e festivalit, fëmijët mundën të paraqisnin përmes pikturës ide të ndryshme mbi temën “Si të mbijetosh...?”. Rreth 60 fëmijë ishin pjesëmarrës gjatë atyre ditëve dhe punimet e tyre u ekspozuan në hyrje të Kino Lumbardhit dhe ITP.

CLIMATE FRESK DISCUSSION WORKSHOP

Punëtorja bashkëpunuese me UNDP Climate Fresk u mësoi fëmijëve shkencën themelore prapa ndryshimeve klimatike, e cila i fuqizoi ata të ndërmarrin veprime në të ardhmen.



EKSPOZITAT

ZBATIMI I DEMOKRACISË

Çka është demokracia sot, çka nënkupton dhe cilat janë konceptet e gdhendura më të rëndësishme pa të cilat demokracia nuk mund të funksionojë? A është e mundur që demokracia të funksionojë? A ka alternativë ndaj demokracisë? Cila është forma optimale e demokracisë?

Kemi biseduar me 62 grupe qytetarësh, iniciativash, aktivistësh, shoqatash profesionale dhe parti politike nga Kosova, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, me qëllim që të zbulojmë se si kuptohet sot demokracia dhe e ardhmja. Përgjigjet që dëgjuam ishin jashtëzakonisht heterogjene dhe varionin nga pikëpamja se “esenca e demokracisë është qytetari i angazhuar, i përkushtuar ndaj mirëqenies publike” e deri në këndvështrimin se “demokracia është një ide e gabuar për shkak të natyrës njerëzore që nuk mund të funksionojë në një sistem të tillë”.

Performing Democracy është një projekt që zhvillohet në bashkëpunim të Kiosk nga Beogradi, Kontra-punkt nga Shkupi dhe DokuFest nga Prizreni. Projekti u mbështet nga: Fondi i Ballkanit për Demokraci, projekt i Fondit Marshall për Gjermaninë i Shteteve të Bashkuara dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID); Allianz Kulturstiftung; Fondacioni i Shoqërisë së Hapur Serbi, dhe Fondi Evropian për Ballkanin.

Autorë të projektit: Ana Adamoviq dhe Milica Pekiq. Redaksia: Ana Adamoviq, Eroll Bilibani, Iskra Geshoska, Veton Nurkollari, Milica Pekiq, Artan Sadiku. Dramaturge: Katarina Pejoviq

Ekspozita ishte e hapur gjatë gjithë festivalit dhe u vizitua nga rreth 200 persona.



HOW DO I SEE YOU?

Ndërtimi i urave ndërmjet të rinjve në Kosovë dhe Serbi për t'i bërë ballë më lehtë qasjes agresive mediatike në rajon. Disa nga synimet e projekti bashkëpunues “SI TË SHOH UNË TY?” ishin që të fuqizoheshin të rinjtë nga Kosova dhe Serbia për t'u përballur me sfidat sociale, që të zbulonin njëri-tjetrin në këto kohë të lajmeve të rrejshme të tmerrshme dhe gjuhës së urrejtjes që janë bërë normë në jetën tonë dhe që të gjindet një pikë takimi e përbashkët. Projekti u financua nga Bashkimi Evropian dhe u zbatua nga DokuFest, Free Zone dhe Fondacioni B92. Gjatë festivalit u hap ekspozita e dytë e punës së pjesëmarrësve dhe u vizitua nga rreth 200 persona. Ekspozita multimediale është pasqyrim artistik i shoqërimit të të rinjve nga Kosova dhe Serbia dhe ju fton t'i bashkoheni hapësirës dhe reflektimeve të tyre.



PANEL DISKUTIMET



EVERYDAY REBELLION

Diskutim mbi përballjen me krizën klimatike, një sistem të shpenzuar të rrjeteve ekologjike, lidhjet e prishura të habitatit dhe larminë e humbur kulturor dhe gjuhësor në një planet të dërrmuar nga mizoritë njerëzore, ne në fakt gjindemi në një situatë të mbijetesës. Ofrimi i drejtësisë, bollëkut, gëzimit dhe gjallërisë për të gjithë do të jenë çështje kryesore për dekadat në vijim, si një sprovë e jashtëzakonshme brenda historisë së njerëzimit. Kjo kërkon një kulturë dhe ushtrim të rezistencës çdo ditë.

Moderuar nga Defne Koryurek me panelistët Ares Shporta, Levon Bagish, Jeton Jagxhiu dhe Sevil Bashturk



LANDSCAPES OF REPAIR AND RESISTANCE

Diskutim në panel u mbajt ndërmjet Catherine Nichols, Jumana Manna dhe Veton Nurkollari mbi peizazhin dhe rezistencën në filmat e Manas dhe se si kjo lidhet me temat më të gjera të Manifesta 14, të tilla si tregime historike dhe bashkëkohore të rezistencës, rimëkëmbjes, shërimit dhe riparimit.



INTRODUCTION TO THE ECONOMICS OF COPYRIGHT-BASED INDUSTRIES

Ofrimi i udhëzimeve për bartësit dhe shfrytëzuesit e të drejtave për mënyrat e mbrojtjes së veprave të tyre dhe kuptimi i rëndësisë së një mbrojtjeje të tillë, si dhe rritja e ndërgjegjësimit të sektorit privat dhe të gjithë hisedarëve për funksionimin efektiv të ekonomisë krijuese. Në bashkëpunim me projektin për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale në Kosovë, i financuar nga BE-ja.

Folës: Dimiter Gantçev, Erkin Yilmaz, Ioannis Kikkis, Irina Lucan Arjoca, Sophie Valais.

THE POWER OF NON-FICTION FILMS

Krijuesit e filmave dokumentarë anembanë botës gjejnë copëza të së vërtetës, magjepsjes, tragjedisë dhe shpresës në jetët e përfaqësuara të njerëzve që ndajnë dashurinë e tyre të të qenurit në një film. Gjatë dekadës së fundit, është shfaqur filmi dokumentar dhe ka kërkuar të shkëputet nga e kaluara e tij koloniale, për t'u kthyer në një mënyrë tjetër të tregimit të historive në formën kinematografike. Si e kanë transformuar kineastët filmin dokumentar në kohën tonë? Dhe a është bërë më i rëndësishëm ai sot?

Moderuar nga Dea Gjinovci me panelistë Maria Silvia Esteve, Martin DiCicco, Jelena Maksimovic dhe Veton Nurkollari.



POST-PARTUM

Post-partum: çfarë ndodh me regjisorin dhe personazhet e tij pas shfaqjes së filmit?

Një nga pyetjet më të zakonshme që u bëhet kineastëve është: Çfarë ndodhi me personazhet/protagonistët tuaj? Ku janë ata tani?

Nganjëherë, kjo pyetje merr një përgjigje të lumtur dhe herë tjera një përgjigje të dhimbshme. Në këtë panel, kineastët u ftuan të flisnin singërisht për ndjenjat e shumta kontradiktore që lindin pas publikimit të filmave të tyre dhe enigmat etike me të cilat përballen.

Moderuar nga Aliriza Arënliu me panelistë Dea Gjinovci, Marija Zidar, Samir Karahoda dhe Ljubomir Stefanov.



HOW TO KEEP ON SHOOTING?

Krijuesit e filmit mund të shtyhen në kufijtë e skajshëm të asaj që ata mendonin se ishin të aftë të bënin. Të bësh një dokumentar shpesh do të thotë të përballësh dhe të përfaqësosh sistemet e padrejtësisë, traditat e vjetruara, dhunën shtetërore dhe korrupsionin dhe shumë nga të këqijat në shoqëri. Ky panel eksploroj se çfarë lloj përgjegjësie mbajnë krijuesit e filmit dhe çfarë i shtyn ata të vazhdojnë së xhiruari, përkundër të gjitha mundësive.

Moderuar nga Dea Gjinovci me Samir Ljuma, Natasa Urban, Zhanna Maksymenko-Dovhych dhe Kumjana Novakova.






HOW TO MAKE AN IMPACTFUL DOCUMENTARY?

Me rritjen e fushatave me ndikim në shkallë të gjerë të lidhura me dokumentarët, ndërthurja në mes të aktivizmit dhe krijimit të filmit nuk ka qenë kurrë më e spikatur. A mundet integrimi i filmave dokumentarë në kornizë kurrikulare me frymëzundryshime sociale. Nga filmimi i aktivizmit te fushata për ndryshim, çfarë do të thotë të bësh një dokumentar me ndikim sot?

Moderuar nga Dea Gjinovci me panelistë Rich Felgate, Ilir Hasanaj, Eroll Bilibani dhe Brigid O'Shea.



WAR CRIMES, SURVIVING THE PAST, BEARING THE FUTURE

Kineastët shpesh kanë qëndruar në ballë të konflikteve dhe luftërave, duke dokumentuar dhe filmuar krimet e luftës dhe pasojat e tyre për të tërhequr vëmendjen globale. Por, sa e ndryshme është të filmosh për qëllime provash që mund të përdoren më vonë në një gjykatë? Çfarë mund të mësohet nga përvojat dhe perspektiva e luftërave ballkanike përballë luftës në Ukrainë? Dhe si duket drejtësia për të mbijetuarit dhe viktimat e krimeve të luftës?

Moderuar nga Dea Gjinovci me panelistë Bekim Blakaj, Nebi Qena, Zhanna Maksymenko-Dovhych, Sasha Romantsova





MASTERKLASAT DHE LIGJERATAT

CINEMA FUTURES AND THE MUSEUM OF CONTEMPORARY ART.

THE CASE OF MUSEO REINA SOFIA LECTURE by CHEMA GONZALEZ

Kjo ligjeratë analizoi funksionet dhe artikulimet e kinemasë në muzeun e artit modern dhe bashkëkohor, duke përdorur Museo Reina Sofia-n (Spanjë, Madrid) si rast studimi. Museo Reina Sofia është një nga institucionet kryesore kulturore të përkushtuar ndaj rimendimit të institucionit të artit, publikut të tij dhe asaj që është në rrezik në muzeun aktual në një skenar global. Përmes kësaj ligjerate janë trajtuar transformimet e kinemasë përgjatë aktiviteteve kryesore të muzeut: historia që diskutohet në ekspozitën e koleksionit, laboratorit i krijimit të imazheve në ekspozitat e përkohshme dhe muzeu si kinotekë alternative në programet e rregullta të filmit.



IN CONVERSATION: MARYAM TAFKORY & MORGAN QUAINANCE

Në këtë sesion të DokuTalk, drejtuesja Pamela Cohn u angazhua me dy të ftuar të veçantë të festivalit, Maryam Tafakory dhe Morgan Quaintance, të cilët panë një retrospektivë të shkurtër të punës së tyre të shfaqur në festival, për një bashkëbisedim të lirë rreth praktikave të tyre artistike, frymëzimeve, metodologjive të punës përmes pamjeve origjinale si dhe atyre të arkivuara, dhe pse ata kanë ardhur në përfundim se imazhi lëvizës është forma më e mirë për shprehjen e tyre artistike.



DOCUMENTARY PRACTICE Masterclass by PAUL LOWE

Udhëhequr nga fotografi i Foto Agjencisë VII Paul Lowe, kjo masterklasë njëditore eksplori se si të hulumtohet, planifikohet, prodhohet, modifikohet dhe paraqitet një ese e zgjeruar fotografike / dokumentar fotografik apo projekt filmi. Ai gjithashtu eksplori dhe vlerësoi në mënyrë kritike shqetësimet etike në lidhje me përfaqësimin dokumentar.



